



KOMUNA E MALISHEVËS



BULETINI

Nr. 117 - Mars 2013 ZYRA PËR INFORMIM - <http://kk.rks-gov.net/malisheve/www.malisheva-komuna.org>



Pamje nga homazhet dhe përkujtimet e ngjarjeve të marsit dhe “Epopesë së UÇK-së”



Përmbajtja

Inspektorati në aksion për respektimin e orarit të punës	3
Malisheva e përgatitur për shënimin e Epopesë së UÇK-së dhe Ditës së Mësuesit.....	3
U mbajtën garat tradicionale në recitim.....	4
Malisheva nderoi dëshmorët e kombit	5
Me rastin e 7 Marsit, çmohet puna e mësimdhënësve malishevas	7
U shënua 8 Marsi – Dita e Gruas	7
Komiteti për Komunitete njihet me punën dhe problemet e HANDIKOS-it	8
Blerim Thaçi është zgjedhur kryesues i komitetit për Arsim dhe Kulturë	8
Siguria e përgjithshme në Malishevë, e qetë dhe stabile	9
U zbulua busti i dëshmorit të kombit Hilmi H. Hoti.....	10
Dëme të vogla nga vërshimet	11
Komiteti për shëndetësi mbajti mbledhjen e saj të tretë	11
KPF dha tri rekomandime për mbledhjen e KK-së.....	12
Në Malishevë u promovua digjitalizimi i testit të maturës	12
U mbajt mbledhja e tretë e Komitetit për Komunitete	13
Kryetari priti palët	14
Malisheva e Klina do të lidhen edhe më shumë me ndërtimin e rrugës Bubël-Sferkë	14
Premtohen mjetet për ndërtimin e ujësjellësit për fshatin Drenoc	15
Prezantim për mbrojtje të ambientit.....	16
KK mbajti mbledhjen e radhës	17
U zbulua lapidari i dëshmorit Abedin Merlaku	18
Bashkatdhetari R.Kastrati ndihmon sportin në Malishevë	19
Përkujtohet të vrarët në masakrën e Burimit	20



Inspektorati në aksion për respektimin e orarit të punës

Malishevë, 1 mars

Drejtorja për Inspektorat, në Komunën e Malishevës, ka bërë të ditur sot, se në bashkëpunim me Policinë e Kosovës, janë në aksion të kontrollimit të subjekteve afariste në tërë territorin e Komunës së Malishevës, për respektimin e orarit të punës dhe kjo drejtori paralajmëron të gjitha subjektet afariste, që do të gjobiten për mosrespektim të orarit të punës.

“Gjatë natës së mbrëmshme, në bashkëpunim me Policinë e Kosovës, inspektorët komunal, kanë kontrolluar të gjitha kazinot dhe subjektet tjera afariste që merren me biznesin e lojërave të fatit, të cilat kanë punuar jashtë orarit të punës”, ka bërë të ditur drejtori i Drejtorisë për Inspektorat, z.Ismet Kafexholli, sipas të cilit, ndaj atyre subjekteve që janë zënë në flagrancë për mosrespektim të orarit të punës, janë bërë proceset dhe kanë shkuar në procedurë të mëtutjeshme.

Me këtë rast, kjo drejtori, ju bën thirrje të gjitha subjekteve afariste në territorin e Komunës së Malishevës, të respektojnë orarin e punës ose në të kundërtën do të gjobiten, sipas rregullores për respektimin e orarit të punës.

Aksioni për kontrollimin e subjekteve afariste, për respektimin e orarit të punës, do të jetë i vazhdueshëm, deri në respektimin e plotë të orarit të punës, sipas rregulloreve në fuqi.

Po ashtu Inspektorati i Malishevës, ka bërë të ditur, se është bërë edhe kontrollimi i subjekteve afariste, për ndalimin e shitjes së llojeve të qumështit, të cilat janë ndaluar nga ana e Agjensionit të Ushqimit dhe Veterinës (AUV) së Kosovës. Sipas drejtorit Kafexhollit, është gjetur një sasi e vogël e qumështit, e cila është ndaluar për shitje, deri në një vendim tjetër të AUV.

Malisheva e përgatitur për shënimin e Epopesë së UÇK-së dhe Ditës së Mësuesit

Malishevë, 4 mars

Në mbledhjen e rregullt të Këshillit të Drejtorëve, i drejtuar nga Kryetari i Malishevës, z.Isni Kilaj, u bë e ditur, se komuna, është përgatitur për shënimin e aktiviteteve tradicionale të muajit mars, me saktësisht shënimin e “Epopesë së Lavdishme të UÇK-së”, me 5,6 dhe 7 mars, si dhe për shënimin e 7 marsit-Ditës së Mësuesit.

Mes aktiviteteve të tjera tradicionale të “Epopesë së UÇK-së”, më 6 mars, do të bëhen homazhe te varrezat e dëshmorëve në Prekaz, Malishevë dhe Kleçkë, si dhe do të mbahet një mbledhje në Asamblenë Komunale të Malishevës, dhe të gjitha këtyre do t’ju paraprijnë aktivitete e ndryshme të cilat lidhen me shënimin e Epopesë së Lavdishme të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës dhe flijimit të Familjes Jashari.

Po ashtu gjatë kësaj jave do të shënohet edhe Dita e Mësuesit, po ashtu me aktivitete tradicionale, siç janë garat në recitim për të gjitha nivelet e arsimit në Komunën e Malishevës, të cilat do të mbahen me datën 5 mars, për të vazhduar me 6 mars, takimet me veteranët e arsimit dhe aktivitete tjera.

Po ashtu organizuar nga zyra për barazi gjinore, me disa aktivitete, do të shënohet edhe Dita Ndërkombëtare e Gruas, me 8 mars.

Përveç njoftimeve për shënimin e këtyre aktiviteteve të datave me rëndësi të marsit, në mbledhjen e Këshillit të Drejtorëve, kryetari Kilaj, kërkoi nga drejtorja e Shërbimeve Publike, të merren me mirëmbajtjen e nënkalimit në fshatin Astrazup dhe Parkun në Mirushë.

Ndërsa drejtori i Drejtorisë së Inspektoratit, njoftoi për aksionin e inspektorëve komunal, në raport me subjektet afariste, të cilat nuk e respektojnë orarin e punës.

U mbajtën garat tradicionale në recitim

Malishevë, 5 mars



Në kuadër të shënimit të Epopesë së Lavdishme të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës dhe Ditës së Mësuesit, sot në Malishevë, organizuar nga Drejtorja për Arsim dhe Edukim dhe në bashkëpunim me të gjitha shkollat, janë mbajtur garat tradicionale në recitim, për të gjitha nivelet e arsimit në Komunën e Malishevës.

“Me këto gara tradicionale, po shënojmë 7 Marsin, dita kur u hap shkolla e parë shqipe në Korçë dhe Ditët e Epopesë së Lavdishme të UÇK-së. Por jo rastësisht këto data shënohen së bashku, pasi arsimdashësit dhe lirisdashësit,

gjithmonë kanë shkuar së bashku tek shqiptarët, dhe pas popuj i kanë të lidhura këto festa”, tha drejtori i Drejtorisë për Arsim dhe Edukim, z.Isuf Morina, i cili më pas ju uroi sukses të gjithë pjesëmarrësve në këtë garë.

Ky aktivitet është zhvilluar në Shtëpinë e Kulturës “Tahir Sinani” në Malishevë.

Komisionet e caktuara për vlerësimin e garuesve, kanë shpallur rezultatet, si më poshtë:

Për ciklin parafillorë

1. Rinesa Krasniqi- SHFMU “Imer Krasniqi”-Carrallukë
2. Donis Krasniqi- SHMFU “Xhevë Krasniqi-Lladroci”-Drenoci
3. Alberinë Gegaj- SHMU “Rifat Berisha”- Berishë

Cikli Fillorë

1. Diana Mazreku - SHFMU “Ibrahim Mazreku”- Malishevë
2. Dafinor Krasniqi - SHFMU “Naim Frashëri” - Banjë
3. Agensa Hoti - SHFMU “Imer Krasniqi”- Carrallukë

Cikli i mesëm i ulët

1. Eronika Hoti – SHFMU “Imer Krasniqi”- Carrallukë

2. Albion Thaçi – SHFMU “Labinot Krasniqi”- Mirushë
3. Diellzë Kleçka – SHFMU “Ibrahim Mazreku”-Malishevë
dhe cikli i mesëm i lartë

1. Endrit Berisha – Gjimnazi “Hamdi Berisha”
2. Endonita Hoti – Gjimnazi “Hamdi Berisha”
3. Pranvera Gashi – SHMPEJ “Lasgush Poradeci”

si dhe për personat me aftësi të kufizuara: vendi i parë Eduard Krasniqi- SHMU “Ibrahim Mazreku”-Malishevë.

Të gjithë fituesit janë shpërblyer nga ana e organizatorit.

Në kuadër të shënimeve të Epopesë së UÇK-së

Malisheva nderoi dëshmorët e kombit

Malishevë, 6 mars



Në kuadër të shënimeve të manifestimit tradicional “Epopeja e UÇK-së”, nën përkujdesjen e Kryetarit të Komunës së Malishevës, z.Isni Kilaj, sot janë mbajtur një sërë aktivitete, në nderim të dëshmorëve të kombit dhe luftës së lavdishme të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, duke filluar me një mbledhje solemne, për të vazhduar me homazhe në Prekaz, Kleçkë dhe Malishevë.

Edhe kësaj radhe, u shpreh indinjata për mbajtjen në paraburgim dhe akuzat, e padrejta ndaj Fatmir Limajt dhe të tjerëve.

Në mbledhjen solemne, kanë folur, Kryetari i Malishevës, z.Isni Kilaj, përfaqësues të partive politike dhe përfaqësuesit e Shoqatës së Veteranëve të Luftës së UÇK-së.

Pas mbledhjes solemne, janë bërë homazhe para shtatores së Komandanti Legjendar Adem Jashari në Malishevë, për vazhduar me vizitën në Prekaz, ku përveç homazheve, delegacioni nga Malisheva, është pritur edhe në kullën e Familjes Jashari, në Prekaz. Pas kësaj, kanë vazhduar homazhet tek varrezat e dëshmorëve në Kleçkë dhe në Malishevë.

Aktivitetet e sotme, janë përmbyllur me një koncert të madh, në Shtëpinë e Kulturës “Tahir Sinani” në Malishevë.



Në vazhdim, fjalimi i Kryetarit të Komunës së Malishevës, mbajtur në mbledhjen solemne:

Të nderuara familje të dëshmorëve,
Invalidë dhe veteranë të luftës së UÇK-së,
Ju anëtarë të Asamblesë Komunale, përfaqësues të jetës institucionale, politike dhe fetare në Malishevë si dhe të gjithë ju pjesëmarrës të kësaj mbledhje solemne.

Edhe sivjet, në 15 vjetorin e Epopesë së Lavdishme të UÇK-së, po përkujtojmë rënien heroike të komandantit legjendar Adem Jashari, të familjes Jasharaj dhe të mijëra dëshmorëve të cilët iu kundërvunë një makinerie gjakatare serbe për të mbetur përjetësisht në panteonin e pavdekësisë. Në histori, jo vetëm në atë shqiptare por edhe në atë evropiane e botërore nuk njihet ndonjë rënie në luftë e komandantit të ushtrisë së bashku me tërë familjen, por kjo ndodhi në Kosovë, në Prekazin e legjendave me 5,6 e 7 mars 1998 kur familja Jasharaj luftoi deri në vetëflijim me një ushtri dhe polici të armatosur deri në dhëmbë.

Lufta dhe rënia heroike në Prekaz pastaj u bë kushtrim për shtrirjen e Ushtrisë Çlirimtare në tërë Kosovën pasi tashmë shihej qartë se ishte moment final i realizimit të aspiratave të shqiptarëve, realizim i sakrificave të panumërta në krejt historinë tonë të dhembshme.

Kushtrimi i rënies së komandantit Adem Jashari dhe familjes së tij me shpejtësi të rrufeshme u përhap edhe në Malishevë.

Mijëra djem e vajza u rreshtuan menjëherë në radhët e Njësiteve “Lumi” dhe “Çeliku” të UÇK-së për të dhënë kontributin e tyre në lirinë e Kosovës kurse secila shtëpi u bë çerdhe për ushtarët e lirisë.

Në histori do të mbeten qindra beteja të zhvilluara në Malishevë, në Dragobil, Lladroc, Carrallukë, Drenoc, Kijevë, Bubavec, Llapqevë, Balincë dhe në të gjitha vendbanimet tjera të Llapushës të cilat u bënë shembuj të luftës dhe qëndresës për liri.

Të nderuar të pranishëm;

Në këtë datë sikur përherë, Malisheva do të përkujtoj jo vetëm 70 dëshmorët e saj por të gjithë dëshmorët e UÇK-së që kushtrimin të lirisë ju përgjigjen nga të gjitha trojet shqiptare, do të kujtojmë sakrificat e të gjithë brezave që nuk kursyen mund, djers dhe gjak për lirinë që sot po e gëzojmë.

Fatkeqësisht, edhe shënimin e këtij përvjetori ne po e shënojmë pa prezencën e një pjese të luftëtarëve të lirisë, po e shënojmë edhe këtë përvjetor pa prezencën e ish komandantit Fatmir Limaj dhe bashkëluftëtarëve të tij Nexhmi Krasniqi, Refki Mazrekut, Naser Krasniqi dhe shokët tanë të tjerë të cilët edhe pas kaq kohe duhet të dëshmojnë pafajësinë e tyre dhe të luftës sonë e cila ka qenë dhe mbetet plotësisht e pastër dhe e drejtë.

Ky përvjetor, sikur edhe përvjetorët tjerë ndërkaq, për ne në Malishevë do të vazhdoj të jetë motivim që të ecim edhe më tej në krijimin e një jete më të mire për qytetarin tonë që ishte amanet i dëshmorëve dhe i të gjithë atyre që u sakrifkuan për liri.

Rroftë Epopeja e lavdishme e UÇK-së.

Lavdi komandantit legjendar Adem Jashari, familjes Jashari dhe të gjithë dëshmorëve.

Me rastin e 7 Marsit, çmohet puna e mësimdhënësve malishevas

Malishevë, 6 mars

Drejtorja për Arsim dhe Edukim, me rastin e shënimit të 7 Marsit, Ditës së Mësuesit, ka mbajtur një takim me mësimdhënësit, drejtorët e shkollave dhe veteranët e arsimit, me ç'rast edhe janë shpërndarë mirënjohje për mësimdhënësit më të mirë.

Drejtori i Drejtorisë për Arsim dhe Edukim, z.Isuf Morina, pasi i përshëndeti të pranishmit, ai i falënderoi të gjithë punëtorët e arsimit, për punën e palodhshme që kanë bërë dhe po bëjnë në arsimimin dhe edukimin e brezave të rinj. “Te gjithë ju veteran, mësimdhënës duhet të jeni krenarë për punën që keni bërë dhe kontributin e dhënë si para, gjatë dhe pas luftës”, tha mes tjerash, drejtori Morina.

Më pas, janë ndarë mirënjohje për shtatë mësimdhënësit më të suksesshëm të Komunës së Malishevës, të cilët gjatë një viti kanë treguar rezultate më të mira në punën e tyre.

Me mirënjohje u nderuan:

Mustafë Hoxha, mësimdhënës në gjimnazin “Hamdi Berisha” në Malishevë, Afet Morina, nga SHMPEJ “Lasgush Poradeci”, në Kijevë, Zenel Berisha- Qendra e Kompetencës në Malishevë, Nezir Kryeziu, nga shkolla fillore “Dëshmorët e Fshatit Bubavec” nga Bubaveci, Rexhep Begaj, SHMU “17 Shkurti”-Banje, Tahir Kelmendi – SHMU “Tafil Kelmendi” Balince, Isa Krasniqi, SHMU “Ganimete Tërbeshi” - Astrazup.

U shënua 8 Marsi – Dita e Gruas

Malishevë, 8 mars



Sot, organizuar nga Komuna e Malishevë, zyra për barazi gjinore, është shënuar Dita Ndërkombëtare e Gruas, me disa aktivitete në Komunën e Malishevës, ku u vlerësua lartë roli i gruas, por në të njëjtën kohë, u tha se duhet bërë edhe më shumë.

“Ne jemi krenar që nga një vend patriarkal, sot jemi një vend i emancipuar dhe ku gruaja sot ka rol udhëheqës, kemi një numër shumë të lartë femrave që punojmë dhe që janë të shkolluara. Por kjo nuk do të thotë të jemi të kënaqur me këtë, pasi duhet të bëjmë edhe më tepër në

emancipimin e femrës dhe rritjen e rolit të gruas në vendimmarrje dhe udhëheqje”, tha mes tjerash, Kryetari i Malishevës, z.Isni Kilaj, në tubimin qendror të mbajtur në Malishevë, me rastin e shënimit të 8 Marsit-Ditës Ndërkombëtare të Gruas.

Një takim tjerët, lidhur me shënimin e 8 Marsit, është organizuar edhe OSBE-ja, ku u vlerësua pozita e gruas në shoqëri, ku nga një shoqëri tradicionale, gruaja ka arritur të merr rolin e gruas udhëheqëse, përmes përgjegjësisë udhëheqëse që ka sot gruaja.

Komiteti për Komunitete njihet me punën dhe problemet e HANDIKOS-it

Malishevë, 11 mars



Anëtarët e Komitetit për Komunitete, z.Hysni Gashi-kryesues dhe z.Fetah Rudi-anëtar, të shoqëruar edhe zyrtarja për komunitete dhe kthim, znj.Edona Krasniqi, kanë vizituar Qendrën e Rehabilitimit “Handikos” në Malishevë, me qëllim të njoftimit me punën dhe problemet që ka kjo qendër, gjatë punës së përditshme me komunitetin e personave me aftësi të kufizuara.

“Qendra e Rehabilitimit, është e vetmja organizatë në Malishevë, që merret me trajtimin, përkatësisht rehabilitimin e personave me aftësi të kufizuara”, tha znj.Feride Hoxha, koordinatore e kësaj qendre, duke i njoftuar anëtarët e Komitetit për Komunitete. Sipas saj, Komuna e Malishevë, tash e tetë vite radhazi e mbështet këtë qendër.

“Këtë vit, Komuna e Malishevë, në tërësi e mbështet qendrën tonë dhe është rasti i vetëm në vend, që komuna e përkrah në tërësi punën e një qendre të këtillë”, tha znj. Hoxha, duke e falënderuar Komunën e Malishevës, për mbështetje. Ajo më pas shtoi, se “pikërisht përkrahja për punën që ata bëjnë, është problemi kryesor”, pasi sipas saj, sa më shumë përkrahja, aq më shumë do kenë mundësi, që t’iu ndihmojnë kësaj pjese të shoqërisë, e cila ka nevojë për rehabilitim.

Anëtarët e këtij komiteti, i kanë dhënë mbështetje Qendrës së Rehabilitimit, dhe kanë premtuar se do angazhohen, brenda mundësive që ata kanë, si organ i Kuvendit të Komunës, për vazhdimin e përkrahjes së kësaj qendre. Ata më pas janë njoftuar edhe me kushtet punës, brenda objektit të kësaj qendre.

Blerim Thaçi është zgjedhur kryesues i komitetit për Arsim dhe Kulturë

Malishevë, 13 mars



Komiteti për Arsim dhe Kulturë, organ i Asamblesë Komunale të Malishevës, ka mbajtur sot mbledhjen e saj të tretë, prej formimit të këtij komiteti, ku pikë kryesore e rendit të ditës, ishte zëvendësimi i anëtarit të ri të këtij komiteti, z.Blerim Thaçi, i cili edhe është zgjedhur kryesues i komitetit.

Në mbledhjen e sotme, ka asistuar edhe kryesuesi i Asamblesë Komunale, z.Ragip Begaj, pasi ish kryesuesja e këtij komiteti, znj.Rajmonda Krasniqi, kishte dhënë dorëheqje dhe ishte zëvendësuar nga kryesuesi i tanishëm,

Blerim Thaçi. Me këtë rast, kryesuesi Begaj, ju premtoi përkrahjen e legjislativit, për të gjitha çështjet që vijnë nga ky komitet.

Komiteti për Arsim dhe Kulturë, i ka uruar nxënësit Alban Kryeziu, i cili në olimpiadën e matematikës, ka zënë vendin e dytë në nivel vendi dhe do të jetë njëri nga përfaqësuesit e Kosovës në olimpiadën botërore, që do të mbahet në Kolumbi.

Në pikën e fundit të rendit të ditës, anëtarët e këtij komiteti, kanë shtruar nevojën e rritjes së cilësisë në arsim, zvogëlimin e mungesave nga ana e arsimtarëve dhe decentralizimin e buxhetit për shkollat. Po ashtu kanë biseduar edhe përgatitjet për mbajtjen e testit të maturës, përfundimin e vitit shkollor dhe përgatitjet për regjistrimin e nxënësve në vitin e ardhshëm shkollor.

Siguria e përgjithshme në Malishevë, e qetë dhe stabile

Malishevë, 14 mars

Situata e sigurisë së përgjithshme në territorin e Komunës së Malishevës, nga organet e sigurisë,



është vlerësuar e qetë, stabile dhe pa indikacione për prishjen e sigurisë së përgjithshme. Ky vlerësim u bë në mbledhjen e Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi (KKSB), ku janë trajtuar edhe disa çështje tjera me rëndësi për punën e këtij këshilli.

“Bazuar në raportet e organeve të sigurisë, situata e sigurisë së përgjithshme, vlerësohet e qetë”, tha drejtori i Drejtorisë për Mbrojtje dhe Shpëtim, z.Halit Zogaj, i cili edhe kryesoi mbledhjen e KKSB-së. Vlerësim të njëjtë ka dhënë edhe zëvendës komandanti i stacionit policor në

Malishevë, togeri Istref Bytyqi, i cili tha se “ nuk ka indikacione për prishjen e situatës së sigurisë së përgjithshme, edhe pse Policia e Kosovës, ka disa shqetësime”.

“Shqetësuese është fakti i konflikteve mes grupeve të nxënësve të shkollave të mesme, konflikte të cilat me gjithë parandalimet që i bën policia, mund të vijnë deri te konfliktet mes familjeve dhe për këtë Policia e Kosovës, kërkon angazhim më të madh edhe të arsimtarëve në shkolla, në mënyrë që të parandalohen këto konflikte”, tha togeri Bytyqi.

Shqetësuese për të gjithë anëtarët e KKS-së, ishte edhe prania e madhe e qenve endacak, pothuajse në çdo vendbanim, ku u paraqit nevoja emergjente për zgjidhjen e kësaj dukurie. Ndërsa zyrtarët e Drejtorisë për Mbrojtje dhe Shpëtim, vlerësuan se gjatë dy muajve të fundit, nuk kanë pasur probleme, as me bllokim të rrugëve nga reshjet dhe as vërshime. Kjo e fundit, për shkak të rregullimit të shtratit të lumit Mirusha.

Në mbledhjen e sotme të KKS-së, përveç njoftimit për udhëzimin administrativ për KKS-të, udhëzim i cili rregullon edhe përbërjen e këtij këshilli, janë njoftuar edhe me Planin e Punës së KKS-së, për vitin 2013, ku anëtarët e këshillit kanë dhënë mendimet e tyre, para se plani të kalojë për diskutim dhe miratim në Asambleenë Komunale.

U zbulua busti i dëshmorit të kombit Hilmi H. Hoti

Carrallukë-Malishevë, 15 mars



Me rastin e shënimit të ditës së Shkollës së Mesme të Ulët “Hilmi Hoti” në Carrallukë, sot u zbulua edhe busti i dëshmorit Hilmi Hoti, emrin e të cilit e mban kjo vatër shkollore, e cila gjithashtu sot shënoi edhe 85 vjetorin e hapjes së saj. Në zbulimin e bustit, morën pjesë familjarë, i pari i Malishevës, z.Isni Kilaj, përfaqësues të institucioneve të ndryshme në vend, përfaqësues të institucioneve lokale në Maqedoni, dhe shumë bashkëluftëtar të dëshmorit.

“Sot kur po qëndrojmë pranë bustit të dëshmorit të kombit, Hilmi Hoti, domosdo kujtimi na kthehet te ngjarjet e rëndësishme që krijoi Hilmiu me shokë, për të bërë luftën e lavdishme të Ushtrisë Çlirimtare Kombëtare në Maqedoni. Por para tyre duhet të kujtojmë me nderimet më të larta të gjitha përpjekjet e popullit tonë për liri dhe të drejta kombëtare. Sot kujtojmë dhe krenohemi me veprën e babait të të Hilmiut, Hysni Hotit dhe shokëve të tij të gjeneratave të ’81-ishit të cilët krijuan gjeneratat e Hilmiut, për të edukuar , frymëzuar, brumosur me frymën kombëtare, e cila më vonë solli luftën e lavdishme të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, Ushtrisë Çlirimtare Kombëtare dhe Ushtrisë Çlirimtare për Preshevë, Medvegje dhe Bujanoc. Tri ushtri të cilat ja kthyen lavdinë populli tonë të



nëpërkëmbur”, tha mes tjerash Kryetari i Malishevës, z.Isni Kilaj, në fjalën e tij, me rastin e zbulimit të bustit të dëshmorit të kombit Hilmi Hoti, emrin e të cilit e mban shkolla në Carrallukë. Kryetari Kilaj, me pas i uroi edhe nxënësit dhe arsimtarët e kësaj vatre shkollore, me rastin e 85 vjetorit të hapjes, si njëra ndër shkollat më të vjetra në Komunën e Malishevës.

Për historikun e shkollës, foli drejtori i kësaj shkolle, z.Jupë Hoti, i cili e krenari foli për emrat e mëdhenj që janë dalë nga kjo vatrë shkollore, përfshi edhe dëshmorin e kombit Hilmi Hoti, emrin e të cilit, tani e mban me krenari shkolla.

Për veprën e dëshmorit Hilmi Hoti, kanë folur edhe përfaqësues të tjerë prezent në ceremoninë e zbulimit të bustit të dëshmorit Hilmi Hoti, si dhe bashkëlloftëtar të tij.

Zbulimin e bustit e bënë, vëllai i dëshmorit Hilmi Hoti, z.Sami Hoti, i pari i Malishevës, z.Isni Kilaj, z.Mehmet Hajrizi, drejtori i shkollës, z.Jupë Hoti dhe zyrtar të institucioneve lokale në Republikën e Maqedonisë.

Paraprakisht, kësaj ceremonie, i ka paraprirë edhe përrurimi i monografisë për shkollën e Carrallukës, “85 vite rritë, dritë dhe dituri...”, e autorit Ramadan Krasniqi, mësues në SHMU “Hilmi Hoti” në Carrallukë.

Dëme të vogla nga vërshimet

Malishevë, 18 mars

Gjatë javës së kaluar, dëmet nga reshjet e mëdha të shiut e borës, kanë qenë shumë të vogla në territorin e Komunës së Malishevës, pasi nga qytetarët ka ardhur vetëm një ankesë, për depërtimin e ujit në bodrumin e lokali afarist, ndërsa uji për një kohë ka penguar lëvizjen e qytetarëve, në hyrje të Malishevës, përderisa ekipet emergjente, kanë qenë në gatishmëri të plotë në rast nevojë, u tha sot në mbledhjen e rregullt të së hënës, të Këshillin të Drejtorëve.

“Rregullimi shtratit të lumit Mirusha, në pjesët ku ka qenë më problem, ka bërë që kësaj radhe të mos kemi vërshime, por ky lum, duhet të pastrohet dhe rregullohet edhe në pjesë tjera, në mënyrë që maksimalisht të evitohen vërshimet nga lumi”, tha Kryetari i Komunës, z.Isni Kilaj.

Në mbledhjen e sotme të Këshillit të Drejtorëve, u diskutua edhe përkrahja për organizatat jo qeveritare, si Handikos, shoqata e të verbërve, shoqata e veteranëve të luftës, pastaj klubet sportive dhe të tjera, të cilat, do të përkrahen brenda mundësive që ka komuna.

Në këtë mbledhje, u diskutua edhe shqetësimi i qytetarëve, lidhur me qentë endacak, të po paraqesin problem, çdo ditë e tepër, për shkak të rritjes së numrit të tyre në rrugët dhe vendbanimet e Komunës së Malishevës.

Komiteti për shëndetësi mbajti mbledhjen e saj të tretë

Malishevë, 18 mars

Komiteti për shëndetësi dhe çështje sociale, mbajti sot mbledhjen e saj të tretë, prej themelimit, ku janë debatuar disa çështje me rëndësi që lidhen me shëndetësinë në Komunën e Malishevës, e në veçanti përgatitja për luftimin e etheve hemorragjike, pasi Komuna e Malishevës, njihet si njëra nga zonat endemike.

Lidhur me çështjen e etheve hemorragjike, përkatësisht, spërkatjen e zonave selektive, si parandaluese nga infektimi me ethe hemorragjike, para anëtarëve komiteti për shëndetësi dhe çështje sociale, sqarimet i ka dhënë drejtori i DSHMS, z.Skënder Hoti, i cili tha se “janë bërë përgatitjet për këtë fushatë të spërkatjes të 39 zonave endemike dhe kjo do të bëhet në dy faza”.

“Paraprakisht, do të mbahen ligjërata dhe fushata vetëdijesimi në të gjitha shkollat, dhe tërë projekti do të realizohet në bashkëpunim mes komunës, Institutin Kombëtar të Shëndetit Publik (IKSHP), ndërsa në këtë fushatë do të jetë e involvuar edhe FSK-ja”, sqaroi drejtori Hoti.

KPF dha tri rekomandime për mbledhjen e KK-së

Malishevë, 19 mars

Komiteti për Politikë dhe Financa (KPF), në mbledhjen e saj të tretë për këtë vit, ka dhënë tri rekomandime për mbledhjen e ardhshme të Kuvendit të Komunës, ku pika kryesore e mbledhjes së ardhshme do të jetë, raporti i punës së Kryetarit të Komunës, për vitin 2012.

Me shumicë të votave, anëtarët e KPF-së, rekomanduan për mbledhjen e ardhshme të KK-së, raportin e punës së Kryetarit dhe Qeverisë Komunale të Malishevës, për vitin 2012.

Po ashtu me shumicë të votave, KPF rekomandoi për kuvend edhe propozimin për plotësim dhe ndryshim të rregullores për Ngarkesa, tarifa dhe gjoba komunale (Rregullorja nr. 02/02 datë, 08.01.2013). Sqarimet për nevojën e këtyre ndryshimeve nga ana e KK-së, para anëtarëve të KPF-së e dha z.Bardhyl Buçaj, shef i drejtorisë së Inspektoratit.

KPF, ka rekomanduar për kuvend, edhe kërkesën e Kryetarit të Komunës, për formimin e Komisionit Komunal të Aksionarëve, komision i cili ka për detyrë, mbikëqyrjen e menaxhimit të ndërmarrjeve komunale. Sqarimet për formimin e këtij komisioni, i dha z.Muharrem Morina, Këshilltar i Kryetarit të Komunës.

KPF-ja po ashtu ka shqyrtuar edhe disa kërkesa të qytetarëve, drejtuar Komitetit për Politikë dhe Financa.

Në Malishevë u promovua digjitalizimi i testit të maturës

Malishevë, 20 mars

Sot në Malishevë, përkatësisht në shkollën profesionale, Qendra e Kompetencës, ka qëndruar zëvendësministri i Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë së Kosovës (MASHTK), z.Nehat Mustafa dhe përfaqësuesit e kompanisë “BIT” nga Austria, të cilët janë pritur nga drejtori i arsimit në Malishevë, z.Isuf Morina, ku qëllim i kësaj vizite, ishte promovimi i projektit për digjitalizimin e testit të maturës.



Projekti për digjitalizimin e testit të maturës, është nënshkruar, ditën e djeshme, mes MASHTK-së dhe kompanisë fituese të këtij projekti “BIT” nga Austria, e cila do ta realizoj këtë projekt, të financuar nga Qeveria e Republikës së Kosovës, me qëllim të implementimit të rekomandimeve të strategjisë “Agjenda Digjitale për Evropë”, e Komisionit Evropian, që ka të bëjë rritjen e cilësisë.

“Kosova, është vendi i parë në rajon, që ka filluar me këtë projekt dhe deri më 2016, ky projekt do të realizohet, pasi këtë vit kemi

filluar me prezantimin e projektit, vitin e ardhshëm do të bëjmë realizimin e pilot projektit dhe në 2016 do të filloj edhe realizimi i tij”, tha zv/ministri i MASHTK-së, z.Nehat Mustafa.

“Për prezantimin e kësaj ideje, kemi zgjedhur shkollën e duhur, pra Qendrën e Kompetencës, këtu në Malishevë, si një shkollë model, për shkak të arriturve në këtë shkollë”, tha zv/ministri Mustafa.

Zëvendësministri Mustafa dhe drejtori i arsimit në Malishevë, z.Isuf Morina, kanë biseduar edhe për çështje të tjera në arsimin e Malishevës, për problemet që ekzistojnë, për derisa nga ana e drejtorit Morina, “arritjet e përgjithshme në arsim, janë të jashtëzakonshme dhe këtë e dëshmon edhe përzgjedhja e Qendrës së Kompetencës, si model për prezantimin e këtij projekti për digjitalizimin e testit të maturës”.

Zv/ministri Mustafa dhe përfaqësuesit e kompanisë “BIT” nga Austria, janë pritur nga udhëheqja dhe mësuesit e Qendrës së Kompetencës në Malishevë, para të cilëve, edhe është bërë prezantimi i projektit për digjitalizimin e testit të maturës.

U mbajt mbledhja e tretë e Komitetit për Komunitete

Malishevë, 20 mars

Komiteti për Komunitete, sot ka mbajtur mbledhjen e njëmbëdhjetë të radhës, ku anëtarët e këtij



komiteti janë njoftuar me punën e organizatave jo qeveritare (OJQ), HANDIKOS dhe Kryqit të Kuq në Malishevë.

Kryesuesi i Komitetit për Komunitet z.Hysni Gashi, i informoi anëtarët e këtij komiteti për vizitën që javën e kaluar ja kanë bërë Qendrës Rehabilituese- HANDIKOS në Malishevë, për punët dhe aktivitetet që zhvillohen në këtë qendër rehabilituese.

Sekretari i degës së Kryqit të Kuq në Malishevë, z.Isuf Morina, ishte prezent në këtë mbledhje, i cili e njoftoi Komitetin për Komunitete, për punën, aktivitetet dhe programet e Kryqit të Kuq në Malishevë.

Kryetari priti palët

Malishevë, 21 mars

Kryetari i Komunës së Malishevës, z.Isni Kilaj, si çdo të enjte, edhe sot, për dy orë rresht, ka pritur qytetarët në zyrën e tij, me qëllim të njoftimit me problemet dhe shqetësimet e përditshme që qytetarët kanë, por në të njëjtën kohë edhe marrë falënderime për mbështetjen e Komunës dhe të Kryetarit, për mirëqenien e qytetarëve të Komunës së Malishevës.

Si zakonisht, edhe kësaj radhe, problemet kryesore të qytetarëve, janë problemet socio-ekonomike dhe çështje të tjera, me të cilat qytetarët përballen çdo ditë. Me këtë rast, kryetari Kilaj, ju ka ofruar mbështetjen e institucionit për çështje të cilat janë kompetencë e komunës.

Në mesin e qytetarëve, të cilët janë takuar me kryetarin, kishte edhe të tillë, të cilët shprehnin falënderimet e tyre, për mbështetjen që komuna dhe kryetari, ju kanë ofruar, qoftë si individ apo komunitet.

Kilaj e Bashota nënshkruajnë marrëveshjen për ndërtimin e rrugës që lidh dy komunat

Malisheva e Klina do të lidhen edhe më shumë me ndërtimin e rrugës Bubël-Sferkë

Malishevë, 22 mars



Kryetari i Malishevës, z.Isni Kilaj dhe Kryetari i Klinës, z.Sokol Bashota, kanë nënshkruar një marrëveshje mirëkuptimi, për ndërtimin e rrugës Bubël-Sferkë, përmes së cilës do të lidhen fshatrat e dy komunave, me shirit të rrugës së asfaltuar, ndërsa qëllim i kësaj lidhjeje, është lehtësimi i lëvizjes së qytetarëve të dy komunave, me qëllim të realizimit të veprimtarive të tyre në mënyrë më të lehtë dhe më ekonomike.

“Rëndësia e këtij projekti është mjaftë e veçantë pasi është një frekuentim mjaftë i madh i atyre qytetarëve që janë të lidhur

edhe miqësisht por edhe me kultura bujqësore në të dyja pjesët e këtyre komunave dhe besojë që më këtë investim u krijohen mundësi dhe lehtësi për të ju qasur shumë më mirë, e më shpejtë qoftë kulturave bujqësore, qoftë lëvizjeve që kanë qytetarët e Klinës me Komunën e Malishevës. E falënderojë kryetarin e Malishevës për mbështetjen e këtij projekti pasi ne i dimë të gjithë mundësitë buxhetore çfarë i kanë komunat në përgjithësi dhe mbështetja dhe investimi në projekt të përbashkët besojë që është inkurajues edhe për projektet tjera për dy komunat fqinje”, tha kryetari i Klinës, z.Sokol Bashota, me rastin e nënshkrimit të marrëveshjes.

“Unë e falënderojë kryetarin e Klinës, Sokol Bashotën, për mbështetje dhe realizim të këtij projekti. Projekti është shumë i rëndësishëm, qytetarët e Klinës që do ta shfrytëzojnë këtë janë sigurisht në numër më të madh por qytetarët e Klinës janë edhe qytetarë të Malishevës dhe anasjelltas, është një projekt shumë i nevojshëm për të dy komunat. Kanë qenë kërkesa të mëdha të dyja komunave për ta ndërtuar këtë rrugë shumë herët, por ne në pamundësi buxhetore sigurisht deri tash s’kemi arritur. Besojë që kemi do ta realizojmë këtë projekt dhe kjo do ti shërbej të gjithëve. Shpesh kur kemi pas kërkesa të qytetarëve na kanë thënë se kjo është rrugë e UÇK-së dhe me të vërtetë ka qenë rrugë e UÇK-së dhe ajo ka rëndësi edhe më të madhe sepse ne edhe vet kemi qenë në ato struktura dhe kemi kaluar shumë herë andej, por kanë kaluar edhe qytetarë të tjerë. Edhe unë po urojë dhe po lutem që të kemi projekte të tjera të përbashkëta”, tha kryetari i Malishevës, z.Isni Kilaj.

Projekti i ndërtimit të rrugës, Bubël-Sferkë, do të realizohet në faza (dy vite) dhe do të kushtoj rreth 220 mijë euro, ku Komuna e Malishevë do të merr pjesë me 80 mijë euro, ndërsa ajo e Klinës, do të merr pjesë me 140 mijë euro.

Premtohen mjetet për ndërtimin e ujësjellësit për fshatin Drenoc

Malishevë, 25 mars

Kryetari i Malishevës, z.Isni Kilaj, ka pritur sot përfaqësuesit e Kryqit të Kuq të Kosovës dhe ata të organizatës IRD, nga të cilët ka marrë premtimin për sigurimin e një pjese të mjeteve për

ndërtimin e ujësjellësit për fshatin Drenoc, ku barrën kryesore do ta ketë komuna, ndërsa OJQ “Jesus Christ” dhe USAID-i, përmes IRD-së, do të sigurojnë pjesën tjetër të mjeteve për këtë ujësjellës.

“Komuna e Malishevës, ka ndarë një fond prej 200 mijë euro për ndërtimin e ujësjellësit për Drenocin, ndërsa ndihma juaj është e mirëseardhur për ndërtimin e tërësishëm të ujësjellësit dhe shpresoj se brenda këtij viti, ky fshat do të ketë ujë për pije nga sistemi i ujësjellësit. Drenoci, përveç që është fshati më i madh, në të njëjtën kohë, është edhe vendbanimi që ka më shumti problem me sigurimin e ujit për pije”, ju ka thënë kryetari Kilaj, përfaqësuesve të Kryqit të Kuq dhe IRD-së.

Zonja Feride Hyseni, sekretare e përgjithshme Kryqit të Kuq të Kosovës, bëri të ditur, se pas takimit të fundit me OJQ “Jesus Christ” (“Kisha e Jezu Krishtit, e ditëve të vona”) nga SHBA-ja, ka ofruar një pjesëmarrje prej 30 dollar amerikan, për kokë banori, në ndërtimin e këtij ujësjellësi.



Në anën tjetër, edhe përfaqësuesi i IRD-së, z.Azem Kastrati, ka bërë të ditur se IRD-ja, nga USAID-i mund të merr pjesë në ndërtimin e ujësjellësit për fshatin Drenoc, me një shumë prej rreth 100 mijë euro.

Zonja Hyseni nga Kryqi i Kuq i Kosovës dhe z.Kastrati nga IRD-ja, “e kanë falënderuar kryetarin Kilaj dhe stafin komunal të Malishevës, kërpo ngrohtësi dhe bashkëpunim të jashtëzakonshëm, në të mirë të komunitetit, përkatësisht popullatës së Komunës së Malishevës”.

Deri më tani për ndërtimin e ujësjellësit

në Drenoc, Komuna e Malishevës, përveç shpimeve për gjetjen e burimit të ujit, ka ndarë edhe një shumë prej 200 mijë euro, ndërsa premtimi për pjesëmarrje nga USAID-i, përmes IRD-së prej 100 mijë euro dhe ndihma e kësaj shoqate amerikane, me nga 30 dollarë për kokë banori, kalon shifrën e 400 mijë eurove, të cilat janë të mjaftueshme, për ndërtimin e pjesës më të madhe të këtij ujësjellësi.

Në ditët e ardhshme, pritet të mbahen takime të tjera, mes Komunës së Malishevës, IRD-së, OJQ “Jesus Christ” dhe Kryqit të Kuq të Kosovës, për diskutuar modalitetet e fillimit të procedurave për ndërtimin e ujësjellësit, për fshatin Drenoc, i cili ka rreth pesë mijë banorë dhe ka problem në sigurimin e ujit për pije.

Prezantim për mbrojtje të ambientit

Malishevë, 28 mars



Sot në shkollat e mesme të larta të Komunës së Malishevës, është mbajtur një prezantim për mbrojtje të ambientit, në kuadër të përgatitjeve për fushatën për pastrimin e ambientit. “Fuqizimi i rinisë përmes mbrojtjes së ambientit”, është projekti i përbashkët i Komunës së Malishevës, OSBE-së dhe Këshillit të Veprimit Lokal Rinor (KVLR), e ku janë të përfshirë edhe Ekipet Vepruese për Siguri në Bashkësi (EVSb), ndërsa një ndihmë në këtë projekt, po e jep edhe KFOR-it, përkatësisht LMT-ja në Malishevë.

KFOR-LMT, ka bërë një prezantim për mbrojtje të ambientit, ku model i ambientit të pastër, është marrë Zvicra. Pjesëtarët e KFOR-it Zviceran, përmes ekipit të LMT-së, e kanë prezantuar para nxënësve të tri shkollave të mesme të Malishevës, modelin zviceran të mbrojtjes së ambientit dh menaxhimit të mbeturinave.

Më pas, zyrtarët e ekipit komunal të OSBE-së në Malishevë, i kanë njoftuar nxënësit për projektin që do të realizohet nga data 2 prill dhe rëndësinë e këtij projekti, ku së bashku me KVLR, Komunën e Malishevës dhe institucionet tjera, do të bëhet pastrimi i ambientit përreth lumit Mirusha, nga qyteti e deri tek liqeni “Mirusha”.

Ndërsa koordinatori për Malishevë, i projektit “Ta pastrojmë Kosovën”, Sejdi Paçarizi, po ashtu i ka njoftuar nxënësit për këtë projekt, i cili do të filloj nga data 2 prill dhe që do të vazhdohet deri në fund të muajit maj.

Qëllimi i këtyre prezantimeve, ishte njoftimi me projektin dhe vetëdijesimin e qytetarëve për ruajtjen e ambientit dhe kjo synohet të arrihet, pikërisht përmes të rinjve, dhe për këtë qëllim, në këtë projekt, janë angazhuar edhe anëtarët e Këshillit të Veprimit Lokal Rinor (KVLR) në Malishevë.



KK mbajti mbledhjen e radhës

Malishevë, 28 mars

Asambleja Komunale e Malishevës, ka mbajtur mbledhjen e saj të XXXVII (e treta e këtij viti) të radhës dhe mbledhja

është udhëhequr nga kryesuesi z.Ragip Begaj. Në këtë mbledhje këshilltarët e Asamblesë Komunale, kanë formuar dy komisione, atë të komisionit komunal të Aksionarëve dhe një komision hetues, për të hyrat në ShMPEJ “Lasgush Poradeci” në Kijevë.

Formimi i komisionit komunal të Aksionarëve, ishte kërkesë e Kryetarit të Komunës, ndërsa do të përbëhet prej tre anëtarëve, ku dy prej tyre do të jenë anëtar të Asamblesë dhe i treti do të jetë i emëruar nga Kryetari i Komunës.

Ndërsa komisioni tjetër për hetimin e të hyrave në ShMPEJ “Lasgush Poradeci”, po ashtu do të ketë tre anëtar dhe është formuar me kërkesën e opozitës (LDK), përkatësisht këshilltarit Januz Kastrati.

Të dy këto komisione janë formuar me shumicë të votave të këshilltarëve në Asamblenë Komunale të Malishevës.

Ndërsa dy pika të parapara për këtë mbledhje janë shtyrë për mbledhjen e ardhshme. Në mungesë të Kryetarit të Komunës, z.Isni Kilaj, i cili gjendet në vizitë zyrtare jashtë vendit, është shtyrë shqyrtimi i raportit vjetorë të punës së Kryetarit të Komunës dhe Qeverisë Komunale, për vitin 2012.

Po ashtu, pas shqyrtimit të propozimeve për ndryshimin e disa neve të Rregullores nr. 02/02 datë, 08.01.2013, që ka të bëjë me ngarkesat, tarifat dhe gjobat komunale. Këshilltarët kërkuar hartimin e një rregulloreje tërësisht të re dhe jo vetëm ndryshim të neneve, pasi një gjë e tillë është kërkuar nga ministria përkatëse.

U zbulua lapidari i dëshmorit Abedin Merlaku

Bubël-Malishevë, 29 mars



Në fshatin Bubël të Malishevës, sot u bë zbulimi i lapidarit të ngritur për dëshmorin e kombit Abedin Tahir Merlaku, i rënë 14 vite më parë në fshat. Në ceremoninë e zbulimit të lapidarit, përveç familjarëve të dëshmorit, morën pjesë edhe përfaqësues të institucioneve lokale të Malishevës dhe Klinës, përfaqësues të organizatave të dala nga lufta, qytetarë të shumtë dhe bashkëlloftëtar të dëshmorit.

“Kjo është ditë e madhe për jo vetëm për familjen e dëshmorit Abedin Merlaku, por edhe për shokët e tij bashkëluftëtar dhe miqtë e tij. Falë gjakut të dëshmorëve dhe luftës së UÇK-së, sot ne jemi këtu”, tha mes tjerash në fjalën e tij, zëvendës ministri i Forcës së Sigurisë së Kosovës (FSK), z.Bejtush Gashi.

“Njerëzit e shenjtë, lënë gjurmë të paharruara në kohë, sikur edhe ky zbulim i lapidarit, për veprën dhe sakrificën e dëshmorit Abedin Merlaku, na bënë që kujtimet tona të jenë të paharruara në rrugën për liri. Kjo rrugë ishte tepër e rëndë për Abedinin dhe shokët e tij, por ishte fat se lufta e jonë, fitoi përkrahjen e shteteve më të fuqishme të botës dhe aleancës së NATO-s”, tha kryesuesi i Asamblesë Komunale të Malishevës, z.Ragip Begaj, në fjalën e tij, i cili më pas në mënyrë kronologjike paraqiti edhe kontributin e trevës së Malishevës, në luftën për liri të UÇK-së.

“Populli shqiptar në të gjitha periudhat ka dhënë emra të mëdhenj në përpjekjet tona historike për liri dhe finalizimin i të gjitha këtyre përpjekjeve ishte lufta e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës. Një prej simboleve të kësaj lufte për liri, ishte Abedin Merlaku”, tha ish komandanti i dëshmorit, Fadil Gashi.

Pas fjalimeve të rastit, është bërë edhe zbulimi i lapidarit të ngritur për dëshmorin e kombit Abedin Merlaku. Zbulimin e lapidarit e bënë, prindi i dëshmorit z.Tahir Merlaku, zv/ministri i MFSK-së, z.Bejtush Gashi, kryesuesi i KK të Malishevës, z.Ragip Begaj, ish komandanti lokal i UÇK-së, Fadil Gashi dhe babai i dëshmorit Mujë Kransiqi-Kapuçi, z.Halil Krasniqi.

Bashkatdhetari R.Kastrati ndihmon sportin në Malishevë

Malishevë, 30 mars



Bashkatdhetari Ramadan Kastrati, nga fshati Turjakë, përsëri ka ndihmuar sportin në Malishevë, me mjete konkretizuese, më saktësisht klubin e futbollit “Malisheva, me ndërresa për ekipin dhe me topa të cilësisë së lartë, duke ju lehtësuar ushtrimet dhe zhvillimin ndeshjeve të këtij klubi futbollit.

Ramadan Kastrati, i cili jeton dhe punon në Lozanë të Zvicrës, si sportdashës, i cili nuk është hera e parë që ndihmon sportin e Malishevës, kësaj radhe ka ndihmuar me një shumë rreth 1500 euro, me

ndërresa dhe topa, përderisa ka thënë se “ndihma për sportin në Malishevë, do të vazhdojë edhe në të ardhmen”.

Këto mjete të bashkatdhetarit Kastrati, i ka pranuar Afrim Selmani, i cili edhe e udhëheq shkollën e futbollit të KF “Malisheva.

Me këtë rast Selmani, pasi e falënderoi bashkatdhetarin Kastrati, tha se “kjo ndihmë, ka për qëllim avancimin e sportit në Malishevë, veçanërisht futbollit”, më tej Slemani, tha se ”synon dhe shpreson se këtë do të startoj me ekip të të rriturve në futboll të madh, pasi kjo shkollë, tashmë ka nxjerrë gjenerata të përgatitura për pjesëmarrje në garat e futbollit në nivel vendi, përdërisa me ekipet e të rinjve ka treguar rezultate shumë të mira”.

Përkujtohet të vrarët në masakrën e Burimit

Malishevë, 31 mars

Familjarë të viktimave të Masakrës së Burimit të Malishevës të dielën në mesditë, në 14 vjetorin e masakrës, kanë bërë homazhe, duke vendosur kurora me lule mbi varret e tyre, që janë të ngritura ndërmjet fshatrave Astrazup dhe Dragobil, si dhe në vendin e masakrës të “Vrella e Mëhillit” në Burim.



Më 31 mars 1999, në vendin e quajtur “Vrella e Mëhillit”, në periferi të fshatit Burim, ishin ekzekutuar 38 shqiptarë, ndërkohë që katër të tjerë ishin djegur. Kjo ka qenë masakra më e madhe që ka ndodhur gjatë kohës së luftës së fundit për liri në komunën e Malishevës.

Në mesin e të vrarëve ka ende edhe persona të paidentifikuar, të cilët janë varrosur nën shifrën “NN”. Shumica e të vrarëve kanë qenë nga fshatrat Dragobil dhe Astrazup, ndërkohë që në mesin e tyre ka pasur edhe mysafirë nga disa fshatra të Suharekës, të strehuar atë kohë në këto dy fshatra.

Për këtë masakër, deri më tani, nuk është ngritur asnjë akuzë dhe rrjedhimisht, askush nuk është dënuar si autor të masakrës.